



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Mbledhje e përbashkët

Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën

Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.10.2018, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfaqësues të organizatave “Think Tank” të shoqërisë civile dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në fushën e monitorimit të proceseve Zgjedhore.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Enkelejd Alibeaj, Vasilika Hysi, Bashkim Fino, Adnor Shameti, Ermonela Felaj, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Xhemal Qefalia dhe Arben Pëllumbi.

Mungojnë:

Jurgis Çyrbja, Astrit Veliaj, Nasip Naço, Tom Doshi, Elena Xhina, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Silva Caka dhe Edmond Haxhinasto.

Të ftuar:

Altin Hazizaj – përfaqësues i CRCA ALBANIA

Rudina Brari - përfaqësues i Shërbimit Ligjor Falas (TLAS)

Premto Gogo – përfaqësues i KRIIK Albania

Afrim Krasniqi - përfaqësues i Institutit të Studimeve Politike

Alfred Bari - përfaqësues i shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Të nderuar pjesëmarrës, siç e dini, në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar një nismë për ndryshime kushtetuese. Institucioni përkatës, që në rastin konkret është mbledhja e përbashkët e Komisionit të Ligjeve dhe Këshillit të Legjislacionit, ka bërë një program në përmbushje të detyrimeve tij kushtetuese dhe procedurale të Rregullores së Kuvendit, ku, përveç problemeve të tjera, siç është vendimi i ekspertëve dhe konstitucionalistëve shqiptarë, por jo vetëm, dhe atyre ndërkombëtarë, siç është kërkesa për Komisionin e Venecies, ka gjykuar dhe ka vlerësuar që të organizojë disa seanca konsultative. Sot po startojmë kontaktin e parë të këtyre seancave, duke autorizuar disa përfaqësues të Komisionit të Ligjeve, të Këshillit të Legjislacionit, si dhe relatorët përkatës të grupimeve politike për të organizuar tryezën e këtyre konsultave.

Sigurisht, ju jeni përfaqësues të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes dhe të drejtave të njeriut, si dhe në fushën e monitorimit të proceseve zgjedhore, kështu që ne kemi njoftuar disa organizata. Kush ka treguar interes për këtë takim është prezent.

Ju kërkoj ndjesë për vonesën, kjo për arsye të agjendës, pasi mendova se nënkryetarja, përfaqësuesit, relatorët, veçanërisht kryetari i Komisionit të Ligjeve do të ishin prezent në këtë konsultë. Prandaj, pa humbur kohë, po ju jap fjalën.

Enkelejd Alibeaj -Së pari, dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj, pavarësisht se jeni të paktë në numër.

Para se të fillonte kjo mbledhje, unë u interesova pranë sekretarisë dhe mora të dhënat se sa përfaqësues të shoqërisë civile ishin njoftuar, dhe ishin njoftuar jo pak, por plot 21 shoqata e grupe, ku sot janë vetëm 5 të pranishëm. Vetëm nga kjo statistikë fare e thjeshtë kuptohet fare mirë që përfaqësuesit e shoqërisë civile, ata të cilët nuk kanë ardhur sot, kanë kuptuar një gjë shumë të rëndësishme në këtë farsë dhe këtë skenë hipokrizie, që është duke zhvilluar kjo godinë.

Ne e kemi thënë që në seancën e parë se iniciativa që kemi marrë ne, si opozitë, për vetëngulim në politikë, përmbajtjen e secilës tashmë e di i madh dhe i vogël kudo në Shqipëri, shumë herë më tepër ju përfaqësues të shoqërisë civile, është një iniciativë, e cila ka vetëm një lloj zgjidhjeje të qasjes politike, pranohet ose jo, përballet ose hidhet në kosh të plehrave. Në fakt, ajo çfarë ndodhi në seancën e parë ishte pikërisht qëndrimi i maxhorancës, e cila me gojë e Kryeministrit, 2-3 ditë para asaj seance, u shpreh publikisht që nuk e pranon vetëngulim në politikë as në përmbajtje, as në frymë dhe as në standard, pra nuk e do. Që në atë moment ne kemi thënë dhe kemi mbajtur qëndrimin se kjo është një tjetër hipokrizi që po zhvillon Komisioni i Ligjeve dhe Këshilli i Legjislacionit me një qëllim të vetëm, për t'i hedhur hi

syve të publikut. Përfundimi i të gjithë kësaj procedure, e cila është shndërruar, në mënyrë aspak elegante, në një procedurë përdorimi dhe fasade të qëndrimit që zotërinjtë përballë nuk duan ta shprehin publikisht apo ta injektojnë, pra mohimin total të kësaj kërkesë urgjente, emergjente dhe ulëritëse të publikut shqiptar është thjesht dhe vetëm për të blerë kohë, duke bërë një teatër.

Sigurisht, konsiderata e parë që kam me respektin më të madh për ju, 5 përfaqësuesit e shoqërisë civile, është që të mos e lejon veten tuaj të përdoren si fasadë, për këtë qëllim, të shprehur tashmë, të mohimit të vetingut në politikë, pra të përdoren nga këta. Ky do të ishte shërbimi më i keq që mund t'i bëhej publikut. Ju keni krijuar emrin tuaj, eksperiencën tuaj, vetë, me kontributin tuaj, pa asnjë lloj ceni, pa asnjë lloj korruptimi me politikën. Ju nuk jeni thirrur asnjëherë në çështjet më delikate, që historikisht ky parlament dhe kjo godinë ka diskutuar, për çështje të drejtpërdrejta të interesit të shoqatës suaj apo të grupeve të interesit që ju mbron, ju thërrasin sot për një çështje, për të cilën e kanë dhënë verdiktin, nuk e duan. Sot janë duke luajtur teatrin hipokrit të radhës, gjasme po konsultohen me shoqërinë civile, do të bëjnë seancën tjetër, do të konsultohen me konstitucionalistë, e çuan në Komisionin e Venecias thjesht dhe vetëm për ta thurur, me aspak elegancë, atë qëllim dhe atë qëndrim që kanë mbajtur.

Megjithatë, për shkak të prezencës suaj, dhe për këtë ju falënderoj, e ndiej si detyrim, meqenëse jemi ne propozuesit, të jap një sqarim të shkurtër për arsyen, për motivet dhe për përmbajtjen e iniciativës sonë kushtetuese. Asgjë më shumë dhe asgjë më pak, standardi i vetingut politik nuk është veçse standardi i vetingut në sistemin gjyqësor për të cilin ju, të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile, jeni angazhuar për një kohë të gjatë, keni dhënë kontributin tuaj, e keni parë atë iniciativë të rritet që nga momentet e fillimit të saj, e patë në momentet e votimit në parlament, e patë në momentet e aplikimit të ligjeve dhe po e shikoni tani edhe të produktit. Ju, më tepër sesa kushdo tjetër, keni një njohje objektive reale, jashtë çfarëdolloj emocioni politik të standardit të vetingut në gjyqësor. Është e keni mbështetur, sigurisht jo me naivitet, e keni mbështetur, ju bën nder. E njëjta situatë, bazuar edhe në disa standarde të thjeshta kushtetuese, i pari është barazia para ligjit, ne e kemi sjellë sot, që standardit të vetingut t'i nënshtrohen jo vetëm gjyqtarët, jo vetëm prokurorët, jo vetëm policët, jo vetëm gardistët, por t'i nënshtrohen ata që janë gjeneratorët kryesorë të të gjitha krizave ekonomike, sociale, institucionale dhe të demokracisë, politikanët. Ne pra, kjo pala këtej, e kemi bërë këtë, pikërisht nisur nga këto motive të aspektit kushtetues. Besoj se këtu asgjë nuk ka asgjë për t'u qortuar, barazia para ligjit, të gjithë të barabartë para ligjit, madje politikanët, më parë se sa gjithë të tjerët, duhet t'i nënshtrohen këtij standardi. Nuk është ky

motivi kryesor, motivi kryesor është diçka tjetër, akoma edhe më e rëndë, situata e vendit, ku ne, politikanët, e ndiejmë edhe mund të mos e ndiejmë, të mbështjellë me emocionin politik, të përfshirë në vorbullën e debatit politik, ndonjëherë mund edhe ta potencoi më tepër nga sa është. Ju, të ftohtë siç jeni në veprimtarinë tuaj të përditshme, të pakompromentuar politikisht keni mundësinë dhe aftësinë për ta ndier pikërisht këtë sensibilitet të shoqërisë publike sot, e cila është, një e vetme, kjo është lidhja e fortë e politikës me krimin. Ky është motivi kryesor, ky është fenomeni, fenomenologjia që mbretëron sot në republikën e shqiptarëve. Banda në çdo qytet të vendit, të cilat kanë ngulur flamurin e zi të vdekjes, ku shteti nuk ekziston dhe ku ligjin e bëjnë bandat dhe banditët. Në Shkodër, në Elbasan, në Durrës, në mes të Bllokut, në Vlorë, vetëm 12 orët e fundit, këtij vendi i mungojnë 5 qytetarë, tre të vrarë dje, një vajzë 13-vjeçare dhe një person tjetër...

Gramoz Ruçi – Avash avash.

Enkelejd Alibeaj – Prit të mbaroj parashtrësën time.

Gramoz Ruçi – Mbledhjen e drejtoj unë.

Enkelejd Alibeaj – Ti mund ta drejtosh mbledhjen, por unë jam anëtar i Këshillit dhe më ke thirrur për konsultim...

Gramoz Ruçi – Të lutem, avash-avash! Nuk të kam thirrur ty për konsultim, por shoqërinë civile...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht, veprimi yt po u heq fjalën këtyre. Të lutem shumë, në qoftë se ato do të kenë pyetje për ty si nismëtar, je i lirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të më dëgjosh?

Enkelejd Alibeaj – Do të më dëgjosh edhe ti mua, se unë jam propozuesi.

Gramoz Ruçi – Do të më dëgjosh mua, se unë jam drejtuesi i mbledhjes.

Më ke kërkuar si drejtues i mbledhjes...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi një minutë? Rregullorja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zotëri, do të flasim ata.

Enkelejd Alibeaj – A ta mbaroj unë?

Gramoz Ruçi – Të lutem, se do të bëj një sqarim.

Enkelejd Alibeaj – Çfarë sqarimi, se do të vazhdoj unë tani?

Gramoz Ruçi – Një minutë, a ka mundësi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, a ka mundësi të vazhdoj unë?

Të dashur përfaqësues të shoqërisë civile, kjo nuk është mbledhje komisioni, por jemi këtu enkas për t'ju dëgjuar ju. Në qoftë se ju keni ndonjë pyetje, pavarësisht se unë jam vënë në dijeni se nga shërbimet e komisionit ju u është vënë materiali në dispozicion dhe ju e keni të nevojshme të bëni pyetje, sigurisht që sot apo një ditë tjetër qoftë nismëtarët, qoftë relatorët, qoftë përfaqësuesit drejtues të komisionit apo të Këshillit të Legjislacionit janë gati t'ju japin shpjegime. Mbi të gjitha, ne jemi të interesuar për mendimet, gjykimet dhe vlerësimet tuaja siç i keni. Sigurisht, për sa i përket tezës që hidhet këtu se kjo është farsë pa filluar fare, se kjo është hipokrizi pa filluar...

Enkelejd Alibeaj – Se çfarë konsideratash kam unë, mos u fut...

Gramoz Ruçi – Ju lutem të keni vlerësimin që do të ishte farsë apo hipokrizi në qoftë se nuk....

Enkelejd Alibeaj – Hajde t'u japim mundësi atyre t'i njohim me çështjen, me lëndën dhe ata të japin secili në mënyrë të lirë opinionin e tyre. Kaq kërkohet.

Gramoz Ruçi – Të lutem, në qoftë se ata kanë nevojë për njohje, do të bëjnë pyetje. Prandaj, t'u lëmë kohë atyre. T'ua lëmë pak kohën atyre

Enkelejd Alibeaj – Pa merak... Kjo puna e kohës...

(Reagime pa mikrofon)

Atëherë, ju të mos ju vijë rëndë dhe keq nga e vërteta. Ne jemi nisur nga këto konsiderata...

Gramoz Ruçi – Ju lutem, ka mundësi?

Enkelejd Alibeaj – Ta mbaroj unë!

Gramoz Ruçi – Mbaroje sa më shpejt që t'u japim kohë atyre.

Enkelejd Alibeaj – Sa më shpejt. E kuptoj që e keni të vështirë ta pranoni. Unë po e mbaroja. Ta kuptoni edhe ju të gjithë: ajo që po them unë sot nuk është retorikë politike; ua kursej unë këtyre zotërinjve. Ajo që unë po deklaroj sot, që do të mbetet edhe në analet e këtij parlamenti, është motivi i vërtetë, për të cilin ne kemi propozuar amendamentet kushtetuese dhe do të gjykojnë zotërinjtë për përmbajtjen, për germën, për teknikën legjislative, por do të gjykojnë edhe për një çështje shumë të rëndësishme: motivet përse ne e kemi paraqitur. Mund t'i gjykojnë jo të drejta, mund t'gjykojnë shumë të drejta, por unë mendoj se këtu është thelbi i gjësë. Shoqëria civile përcjell zërin e pastër të shoqërisë, të publikut shqiptar. Prandaj na keni thirrur, apo jo? Cili ishte motivi?! Ky ishte motivi, pra gjendja e rëndë e vendit sot, e kapluar nga krimi, ku bandat kanë vendosur edhe një herë flamurin e zi të vdekjes. Pyetja

është: pse ky fenomen, që nuk ka ndodhur ndonjëherë të paktën në 30 vjet, të lulëzojë sot? Ne besojmë dhe kemi prova se ky fenomen ndodh vetëm për shkak të një motivi: të lidhjes së fortë të krimit të rrugës, të llumit me politikën, me pushtetin, me qeverinë, me Kryeministrin. Nuk është thjesht sensibiliteti ynë i njëanshëm partiak, por besojmë se është publik, bazuar në prova dhe në fakte. Si shpjegohet që një përfaqësues i lartë i kësaj maxhorance, kryetari i grupit parlamentar të këtyre, Taulant Balla, del në të gjitha episodet kriminale, së paku, të muajve të fundit, 4-5? Si shpjegohet që një deputet, kolegu i këtyre, Çyrbja, flet pa teklif me bandën e Shullazit? Si shpjegohet që i biri i një deputeti këtu merr, rrëmben, torturon, dhunon, i mbrojtur nga i ati, një viktimë të pafajshme? Të gjitha këto elemente janë fakte dhe prova, të cilat janë publikisht të ditura dhe unë besoj se çdo shqiptari, pavarësisht orientimit të tij politik, pavarësisht preferencave të veta politike, bëjnë të mendojnë se kjo situatë do një zgjidhje, sepse në total e gjithë kjo situatë ka sjellë sot një dëm të madh. Sot nuk ka më sistem politik; sot nuk ka më sistem demokracie, sot ka vetëm një regjim, një diktaturë të pastër në mbrojtje të krimit. Po si mundet sot, në këtë situatë, ku përfshihen kryetari i grupit parlamentar, drejtori i Përgjithshëm i Policisë, të cilët merren dhe fokusohen si e si të fabrikojnë prova dhe dëshmitarë thjesht dhe vetëm se një gazetar dhe një deputet i opozitës denoncuan krimin, i kanë shndërruar dhe i kanë vënë minat sistemit të drejtësisë?!

I gjithë ky fenomen besojmë se buron dhe gjenerohet pikërisht nga lidhja e krimit me politikën, se nuk ka mundësi tjetër që krimi të marrë flatra sot. Ka pasur edhe më përpara fenomene kriminale, por fenomen kriminal, i cili të ketë guximin që në mes të Bllokut të nxjerrë armët e të qesë pushkë, këtu ka rënë shteti, këtu ka rënë e tashmja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...ka rënë edhe e ardhmja!

Për këtë arsye, përsëri shumë respekt për ju, përfaqësues të shoqërisë civile, sigurisht respekt për ata që nuk kanë ardhur, sepse e kanë kuptuar hipokrizinë e madhe që janë duke bërë këta njerëz me këtë çështje, por respekt edhe për ju, sepse teksa po merrja emrat se cilët janë përfaqësuesit, realisht unë besoj se ju kanë vendosur në një pozitë të vështirë, në të cilën shpresoj që ju nuk do të bini brenda. Cila është kjo pozitë e vështirë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Konsultimin që do të bëjnë me ju, do ta shesin nesër, them unë, sipas eksperiencës, si një konsultim me shoqërinë civile për një vendim që e kanë marrë më përpara. Në fakt, unë besoj që, ashtu sikurse keni krijuar edhe emrin tuaj në shoqërinë civile, pa mbështetjen e pushtetit, pa mbështetjen e çdo kompromentimi politik, nderin që keni krijuar deri tani, po marr vetëm përfaqësuesit e shërbimit ligjor TLAS...

Zonja Rudina Brari, shumë faleminderit që keni ardhur! Por unë besoj se nëse ka një çështje që është edhe motivi pse ne, të opozitës, kemi paraqitur këtë amendament, është ajo për ato viktimë që ju i keni mbrojtur sa e sa vite, viktimë të dhunuara...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...të terrorizuara, si Xhisiela.

(Debat në sallë)

Keni argument shumë të fortë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Mos ma hiqni fjalën! Ta mbaroj unë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kam një orë që...

Gramoz Ruçi – Nuk të lejoj më!

(Deputeti Alibeaj flet pa mikrofon.)

Asnjë sekondë!

Enkelejd Alibeaj – Pse ju dhemb e vërteta, mor burrë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Shantazh!

Enkelejd Alibeaj – Edhe tri minuta dhe e mbaroj fjalën time.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Tri minuta, me orë në dorë, dhe mbaroj!

Gramoz Ruçi – Asnjë sekondë! Nuk kam ardhur unë këtu të të dëgjoj ty!

Enkelejd Alibeaj – Kë do të dëgjosh ti?

Gramoz Ruçi – Kam ardhur të dëgjoj ata!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Ore, do t'i dëgjosh ata, por për amendamentin që kemi paraqitur ne!

Gramoz Ruçi – Në qoftë se ata...

Enkelejd Alibeaj – Lidhur me amendamentin që kemi paraqitur ne...

Gramoz Ruçi – Të lutem! Për ato amendime që, në qoftë se ju...

Enkelejd Alibeaj – Meqenëse e ke nisur si teatër, mos e humb toruan, vazhdojmë!

Gramoz Ruçi – ...do të ishit i interesuar.

Enkelejd Alibeaj – Ja, pra, ja po i them unë!

Gramoz Ruçi – Jeni i interesuar?

Enkelejd Alibeaj – Jam shumë i interesuar, prandaj edhe kam ardhur.

Gramoz Ruçi – Në qoftë se jeni i interesuar, le të dëgjojmë ata.

Enkelejd Alibeaj – Jam i interesuar edhe të demaskoj hipokrizinë tuaj.

A ka mundësi ta mbaroj unë, edhe tridhjetë sekonda?

Gramoz Ruçi – Jo, nuk të jap më të drejtë fjale!

Enkelejd Alibeaj – Ore, nuk më ndalon...

(Deputetit Alibeaj i ndërpritet fjala.)

Gramoz Ruçi – Të lutem!

Enkelejd Alibeaj – Ja, ky është shembulli, për të cilin ju kanë thirrur juve.

Gramoz Ruçi – Nuk ju lejoj t'i intimidosh përfaqësuesit e shoqërisë civile këtu! Ju lutem shumë!

Enkelejd Alibeaj – Në qoftë se ndonjëri prej jush flet diçka...

(Deputeti Alibeaj e vazhdon fjalën e tij pa mikrofon.)

Gramoz Ruçi – Ju lutem!

Enkelejd Alibeaj – ...për krimin, flet diçka për bandat, ju... Censurojeni!

Gramoz Ruçi – Mund ta merrni fjalën, të nderuar përfaqësues.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush e do fjalën?

Enkelejd Alibeaj – ...me zonjën, për respektin që kam për gjithsecilin nga pak.

Vasilika Hysi – Çfarë do t'i bësh, mor?

(Deputeti Alibeaj flet pa mikrofon.)

Alket Hyseni – Dil jashtë!

Gramoz Ruçi – Të lutem tani!

(Deputeti Alibeaj flet pa mikrofon.)

Enkelejd Alibeaj – I ke mbrojtur në heshtje!

Gramoz Ruçi – Do t'i bësh diskutimin Xhisielës, ti?

(Deputeti Alibeaj flet pa mikrofon.)

Enkelejd Alibeaj – Ke mbrojtur fëmijët e këtij vendi.

Ti e di fare mirë se fëmijët e këtij vendi në gjimnaze helmohen me drogë!

(Deputeti Alibeaj vazhdon të flasë pa mikrofon.)

Sot ke një motiv mjaft të fortë për të thënë, sepse pikërisht krimi i mbështetur nga politika bën që...

Alket Hyseni – Zoti Kryetar, ju lutem, është nonsens! Nuk mund të vazhdojë kjo mbledhje kështu!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ju lutem, avash!

Enkelejd Alibeaj – Zonja e zotërinj, shumë faleminderit për të gjithë ndihmën e madhe!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I keni dhënë ndihmën më të madhe reformës zgjedhore historikisht, por sot keni një motiv shumë të fortë për të treguar se në çfarë derexheje ka arritur procesi elektoral; përfshihet vetëm në një sentencë, në sentencën që ka Rexhep Rraja.

Do të shihet një krah i opozitës në zgjedhje, në votime. Ai, njeriu që me armë e rrëmbeu vajzën, i djeg cigaret, e preu...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Zoti Alibeaj, do t'i lëmë ata të shprehen vetë, apo do t'ua bëjmë diskutimin ne? Lëre, mor, se flasin vetë ata!

Enkelejd Alibeaj – Përfaqësuesi i shoqërisë civile...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të mbaroj?

Gramoz Ruçi – Çfarë do të bësh ti, diskutimin e tyre?

Lëre, ore, se nuk mendojnë ata as çfarë mendon ti, as çfarë mendoj unë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Shumë faleminderit që keni ardhur...

(Debat në sallë)

Gramoz Ruçi – A ka mundësi tani t'i lini llafet?

Enkelejd Alibeaj – ...hipokrizia më e madhe: një gazetar dhe një opozitar janë marrë sot nën hetim dhe nën persekutim politik nga celula kriminale në prokurori!

Ka rënë i gjithë sistemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...sepse ai që rri në anën tjetër të godinës nuk do t'ia dijë për sistem të pavarur drejtësie! Nuk do t'ia dijë për sistem prokurorie! Ka vendosur dordolecët e vet të konkludojnë të gjithë së bashku.

... *(nuk dëgjohet)* duke e kthyer ... *(nuk dëgjohet)*

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse sot një gazetar apo opozitar denoncon fenomenin kriminal, është njësoj si të bëjë agjitacion dhe propagandë. Sot po e provojnë edhe me gazetarët ... *(nuk dëgjohet)* mendoni çfarë i bëjnë publikut këta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ka mundësi t’i japim fjalën ...?

Enkelejd Alibeaj – E fundit fjalë që kam është ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Të lutem, sepse ka edhe fjalinë e fundit për të thënë.

Enkelejd Alibeaj – ... Kam besim dhe jam shpresëplote që ju ... *(nuk dëgjohet)* për të thënë të vërtetën, por mbi të gjitha për të mos rënë në kurthin që ju kanë përgatitur këta, për t’ju përdorur si ... *(nuk dëgjohet)*

Tentojnë t’ju përdorin ju për të krijuar fasadat e shoqërisë civile ... *(nuk dëgjohet)*

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Enkelejd Alibeaj - Sot është momenti që zërat më të fortë të shoqërisë civile ... *(nuk dëgjohet)*

Ulsi Manja – Ik se filloi filmi.

Gramoz Ruçi – Ju kërkoj ndjesë, të nderuar!

Unë ju thashë që në fillim të mbledhjes së Këshilli i Legjislacionit dhe Komisioni i Ligjeve kanë bërë një program për të dëgjuar, jo për të na dëgjuar ju, lidhur me këtë nismë. Do të ishte hipokrizi dhe fasadë sikur të diskutonim një nismë kushtetuese dhe të thoshim që do ta miratojmë brenda një jave pa dëgjuar më parë të gjithë aktorët dhe faktorët e një shoqërie dhe pa lënë një kohë në dispozicion për ta prezantuar, për t’u njohur dhe mundësisht për të ndikuar deri te votat në parlament për ta miratuar apo për ta rrëzuar. Nuk mund të paragjykojmë sot as që do të miratohet dhe as që nuk do të miratohet.

Së dyti, nuk mund të paragjykojmë asnjë nga ata që i janë përgjigjur pozitivisht ftesës, nga ju që jeni këtu, apo nga ata që s’kanë ardhur. Ky grafik do të zbatohet nga ana e komisionit përkatës të ngarkuar me këtë detyrë institucionale. Do të na falni për çështjen, por me sa duket kjo është kultura dhe edukata e ne politikanëve shqiptarë.

Unë ju thashë që në fillim se për të ndjekur këto tryeza janë ngarkuar nënkryetarja e Kuvendit, kryetari i Komisionit të Ligjeve, kryetari i Këshillit të Legjislacionit, si dhe dy relatorët e dy grupimeve politike, profesoreshë Hysi, nga maxhoranca dhe zoti Bylykbashi nga minoranca. Këta do të jenë aktorët dhe faktorët që

do të organizojnë këto tryeza dëgjimore dhe këshillimore të organizuara në harkun kohor të dy muajve tetor dhe nëntor.

Kuptohet, nuk është gjë e mirë që në vend që t'ju dëgjonim ju, dëgjuam përfaqësuesin e opozitës, në një kohë që këtu duhet të ishte relatori i përcaktuar nga opozita për të dëgjuar mendimet. Ky do të ishte vlerësimi më i madh që do të bëhej për mendimin dhe qëndrimin tuaj.

Kështu që, ju lutem, çfarëdolloj mendimi apo sugjerimi që do të keni, jeni të ftuar ta jepni shkurtimisht. Nëse dikush e ka përgatitur me shkrim apo kërkon kohë në dispozicion që ta përgatisë me shkrim, është i lutur ta paraqesë apo depozitojë kur ai e mendon (kjo vlen edhe shoqatat që nuk kanë ardhur sot), me qëllim që të kursejmë kohën e vyer që ju mund ta përdorni për të zgjidhur probleme të tjera.

Fjala është për ju.

Do të më lejoni t'ia kaloj drejtimin e mbledhjes zëvendëskryetares së Kuvendit që ta vazhdojë seancën, për arsye të axhendës që unë kam. A biem dakord me këtë, kolegë?

Kush e do fjalën?

Urdhëroni!

Prezantohuni në fillim!

Premto Gogo - Përshëndetje të gjithëve!

Unë quhem Premto Gogo dhe vij nga Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë.

Ju falënderoj për ftesën!

E mora jo pa qëllim fjalën i pari, sepse unë përfaqësoj atë grupim organizatash të cilat janë ndër më të vjetrat dhe më të mëdhatë në vend, që kanë krijuar integritet dhe pavarësi të respektuar nga palët.

Do të ishte mirë që zoti Alibeaj dhe propozuesit të ishin këtu, meqenëse ftesa vjen nga institucioni i Kuvendit dhe jo nga PS-ja. Megjithatë, më duhet të parashtroj në parantezë dy momente, të cilat nuk janë fort të shëndetshme për këtë konsultim publik që po bëhet, i cili duhet përshëndetur në zbatim të frymës së ligjit për konsultimin publik dhe që duhet të shtrihet në këtë formë edhe në të gjitha nismat e tjera ligjvënëse (në formën më të mirë të mundshme), për faktin se pavarësisht se si do të shkojnë diskutimet sot, jo thjesht për hir të parantezës, që u bë midis deputetëve të opozitës dhe juve, por për momentin politik, jam i sigurt që disa prej nesh do t'u atashohen qëndrimeve të majta apo atyre të djathta. Kështu, ky moment është momenti më i papërshtatshëm që të thirret shoqëria civile, kur partitë politike i kanë radikalizuar qëndrimet për çështje të caktuara, pa i hyrë çështjes në brendi.

Momenti tjetër, që unë e quaj të papërshtatshëm është që ky projektligj ka shkuar në Komisionin e Venecies. Unë nuk e di, nëse ky konsultim do të ketë një qasje thjesht në nivelin politik, një qasje të germës, të procedurës, të teknikës legjislative etj., ndërkohë që opinioni i Komisionit të Venecies është ai që do të pranohet *apriori* dhe do të jetë absolutisht një energji e shkuar dëm, përpos qasjes politike. Kështu, në këtë aspekt, më lejoni që diskutimin tim ta mbaj në nivelin politik.

Zonja drejtuese, a mund të di kohën që kam në dispozicion, në mënyrë që t'i rendis problemet?

Vasilika Hysi – Keni 5 minuta.

Premto Gogo – Faleminderit!

Më lejoni që diskutimin tim, si përfaqësues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë, ta mbaj në nivelin politik!

Pavarësisht se nisma është debatuar shumë, mendoj se duhet ndarë në 3 momente: nisma si qasje, procedura dhe zbatimi i vet.

Në pikëpamje të qasjes politike, lidhur me këtë nismë, nëse është e nevojshme ose jo, koalicioni ynë i ka denoncuar me forcë dhe i ka vazhduar denoncimet e tij dhe hapat për ta adresuar siç duhet fenomenin e korrupsionit zgjedhor, i cili ka prekur dhe prek thelbësisht procesin e zgjedhjeve në Shqipëri, atë proces, i cili legjitimon këtë godinë të nderuar, organin më të lartë prej të cilit gjenerojnë të gjitha pushtetet dhe të gjitha politikat në vend.

Nga ana tjetër, për më shumë se 2 vjet, ne në takimet tona kemi sjellë në vëmendje rrezikun e kapjes së shtetit, pikërisht për efekt të mosfunksionim të një sërë strukturash, të situatës politike dhe të mënyrës se si zhvillohen zgjedhjet. Në këtë aspekt, duke pasur parasysh që vendi ka hyrë në reforma radikale, siç është procesi i reformës në drejtësi, i vetëngut të magjistratëve, i vetëngut të policisë, të dekriminalizimit, që janë reforma realisht radikale, që ne i kemi pranuar dhe ju i keni pranuar. Unë ju përgëzoj për adresimin e këtyre shqetësimeve në funksion të një të ardhmeje të konsoliduar të demokracisë në vend!

Ajo që ka mbetur pa u prekur, është pikërisht pjesa e politikës. Në këtë pikëpamje, mendojmë se është i nevojshëm ky lloj vetingu në qasje politike si nismë, por sigurisht, pa u hyrë diskutimeve dhe detajeve, që do të jenë për një moment të dytë, kur shumica prej 3/5-ve do të adresojë ligjin, nëse do të ketë vullnet politik dhe që do të qartësojë se çfarë quhet krim i organizuar apo kontakte të papërshtatshme etj. Momenti thelbësor, që është një fakt kokëfortë, është justifikimi i pasurisë për deputetët, për drejtuesit dhe anëtarët e institucioneve, që emërohen me ligj prej Kuvendit. Në këtë pikëpamje, ne e mbështesim, sepse ne mendojmë dhe kemi kohë që e themi se sot mungon moraliteti i politikës, është

nevoja për integritet dhe këtu nuk e kam fjalën për zgjedhjet që do të vijnë, ato që kanë ikur apo ato të legjislaturës që vjen, por e kam fjalën për të ardhmen e demokracisë, për frymën që u jepet të rinjve dhe për modelin që u jepet turinjve, nëse do të ketë moralitet për zyrtarët publikë, që votojnë ligjet, për ata, që drejtojnë institucionet, për ata që i zbatojnë reformat qeverisëse apo do të jepet shfaqja e shëmtuar që është dhënë deri sot dhe që të gjithë e dimë dhe e kemi diskutuar në tryezat, ku kemi marrë pjesë dhe së fundi, edhe në dokumentin që kemi çuar në Komisionin për Reformën Zgjedhore, ku përpiqemi të adresojmë pikërisht këtë shqetësim, rrezikun e kapjes, sidomos të parive politike nga interesat private, i kemi quajtur ne në thonjëza, por edhe nga paratë e pakontrolluara, financimet e pakontrolluara e të tjera që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me pasurinë. E quajmë me vend që fillimi të jetë për parlamentin, fillimisht për deputetët dhe ata që emëron parlamenti, sepse integriteti në radhë të parë dhe moraliteti i takon këtij parlamenti. Por ajo që ne mendojmë se është e nevojshme dhe e sugjerojmë, është se nëse do të ketë vullnet politik, të cilin e nxisim që të harmonizohet edhe me pjesën e adresimit të reformës zgjedhore, të dyja forcave politike, por edhe të forcave të tjera parlamentare, duke përfshirë ato jashtë parlamentit dhe aktorë të tjerë, të bëhet një harmonizim i legjislacionit pa prekur, pa krijuar efekte dhe pa ndikuar proceset që tashmë kanë nisur: procesin e reformës në drejtësi dhe vetingun, por harmonizim, për të sjellë këtë qasje moraliste dhe ruajtjen e integritetit të të gjithë personave që ushtrojnë funksione ose kanë ndikim në opinionin dhe në skenën publike. Madje mund të shkohet edhe aty, që dhe strukturat e tjera apo institucione të tjera me ndikim në skenën publike të mund t'i nënshtrohen një lloj vetingu, i ngjashëm me këtë apo të tjera që mund të gjykohen. Këtu e kam fjalën në radhë të parë për strukturat e OJF-ve, partitë politike, përfshirë edhe organizatat si ato tonat që punojnë në fushën e demokracisë dhe të drejtat e njeriut, sindikatat, mediet apo edhe të tjerë, pa çdo aktor që ka ndikim publik për të kontrolluar këtë lloj integriteti dhe qasje moraliste. Nuk mund të propagandohen parime, zbatimi i ligjit nga individë, të cilët njerëzit, shoqëria, populli i ka parë dhe i shikon. Këtu e kam fjalën për pjesën e zgjedhjeve, jo atë pjesë të opozitës, sepse nëse flasim për shitblerjen e votave, nëse flasim për drejtim, dhunim apo shpërblime kemi të bëjmë me këtë moment që jemi. Një vend shumë i vogël me lidhje të ngushta, absolutisht që duhet të jemi të kujdesshëm, ku është ndërtuar një sistem patronazhi politik i shpërblimit të votës, i drejtimit, orientimit apo i dhunimit. Janë këta individë që kur dalin në terren, që në një moment të caktuar do të vijnë dhe do të bëhen zbatues të politikave publike, në mos kanë bërë vetë, të mbyllin sytë përballë fenomeneve të tilla apo i mbështesin ato në forma të tjera.

Kjo ishte ajo që doja të prezantoja si qëndrim i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë lidhur me këtë nismë. Nëse ka nevojë për detaje të tjera, qoftë edhe në nivel të ligjit, nëse do të ketë vullnet politik, ne jemi të gatshëm ta ofrojmë, por pasi të vijë edhe opinioni i Venecies.

Ju lutem, ju nxis me forcë edhe një herë që të gjeni vullnetin politik! Shfaqja e shëmtuar e dy ditëve të para të kësaj jave, ku u bë platforma elektorale e të të dyja partive kryesore pas 8 muajsh që komisioni ka punuar në grupe pune dhe nuk ka ende një produkt, e kemi thënë përvijon rrezikun e një radikaliteti të ri politik. Vendi nuk mund të mbajë dot një të tillë, prandaj ju nxisim si forca politike, që zgjidhja të jetë absolutisht institucionale, të gjeni mekanizmat dhe vullnetin e duhur për t'i dhënë vendit reformën elektorale dhe për të adresuar shqetësimet, të cilat do të sigurojnë ato që janë aspiratat kushtetuese: votimin e lirë dhe të barabartë për qytetarët, ku qytetari është sovran dhe alternativat janë të lira, ka konkurrencë platformash, ku partitë politike funksionojnë në mënyrë demokratike dhe nxiten të gjithë kandidatët apo çdo alternativë politike në mënyrë konkurente, me qëllim që të mos t'u jepet qytetarëve në ditën e votimit një zgjedhje e kushtëzuar apo e detyruar, edhe nëse ata shkojnë atje me vullnet të lirë.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Premto!

Ka pyetje nga kolegët? Nëse nuk ka të tilla, do të më lejoni të bëj një sqarim lidhur me sugjerimin ose fjalinë e parë që thatë ju, se nuk duhet të ishte thirrur shoqëria civile në këtë situatë të tensionuar politike. Sipas nenit 77, germa “a” të Rregullores së Kuvendit, kur ka një nismë për rishikimin e Kushtetutës ajo menjëherë i vihet në dijeni seancës plenare dhe jo më parë se dy javë nga data e depozitimit, jemi të detyruar të fillojmë procesin e shqyrtimit të nismës.

Në paragrafin e tretë të nenit 77, germa “a” të Rregullores theksohet se caktohen dy relatorë. Kjo procedurë është bërë. Relatorë janë zoti Bylykbashi dhe unë, por njëkohësisht Rregullorja na detyron që të fillojmë seancat dëgjimore publike menjëherë. Mbledhja vendos për mënyrën sesi do të njoftohen zgjedhësit, thirren konstitucionalistët. Kjo gjë është bërë, janë caktuar këta të fundit, janë dhënë detyrat e tyre, pyetjet. Ndërkohë mbledhja për rishikimin e Kushtetutës dhe seancat dëgjimore bëhen të hapura për median dhe publikun.

Ky proces duhet të vazhdojë, përndryshe jemi në shkelje të Rregullores.

Shqetësimi i kolegëve të opozitës, ndoshta ku nuk e keni ditur, është se nuk kanë dashur fare të dëgjoheni, as të dërgohet në Komisionin e Venecias, por të miratohej brenda javës, gjë që binte ndesh me Kushtetutën, te kreu, që flet për rishikimin kushtetues, dhe te Rregullorja e Kuvendit.

Si informacion dhe transparencë për ju e për publikun, është miratuar një kalendar, në një mbledhje ku kanë qenë të pranishme maxhoranca dhe opozita. Ka shtatë seanca dëgjimore dhe kjo është seanca e parë. Seancat e tjera do të vijojnë me profesorë të universiteteve publike e jopublike, me profesionet e lira, me institucionet, me partnerët ndërkombëtarë. Pastaj do të jemi nëpër rrethe, në qytetet ku ka fakultete të drejtësisë, të shkencave politike, duke ftuar aty edhe shoqërinë civile. Kjo është bërë paralel, për t'ju informuar, që të fitojmë kohë, sepse nga opozita është këmbëngulur me të madhe që nuk duhet humbur kohë.

Për sa i përket Komisionit të Venecias, padyshim që do të shkonte edhe në Komisionin e Venecias. Është e drejta e Kuvendit, që të përcaktojë dërgimin e kësaj nisme. Unë ju kërkoj shumë ndjesë që sot u vutë në një pozitë të vështirë. E kuptoj si ndjeheni, por ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën parlamentare, dhe në kuadër të konsultimit publik, por edhe të një manuali të miratuar në lidhje me pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje, do të ftojme shoqërinë civile. Siç keni qenë dje, pardje e në ditët e mëparshme, dhe siç do të jeni nga e hëna e në vijim, për shumë nisma të tjera që kemi në komision.

Kjo është situata, zoti Premto, por ne nuk mund të rrimë peng, sepse parlamenti ka maxhorancë e opozitë dhe vendi drejtohet. Ka institucione. Nuk mund të rrimë derisa kolegët të zgjidhin problemet. Jam dakord me pjesën tjetër, se duhet gjendur konsensusi. Megjithatë, ne jemi këtu për të zbatuar Rregulloren.

Shumë faleminderit!

Ndërkohë, ju mund ta përcaktoni vetë radhën, nëse dëshironi.

Po, zoti Premto! Ju lutem!

Premto Gogo – Faleminderit, zonja Hysi!

Absolutisht që është ligjore. Nuk kemi asnjë objeksion lidhur me këtë pjesë, por gjykojmë se edhe ju duhet ta mbani parasysh situatën tepër delikate të shoqërisë civile, sidomos të asaj pjese të organizatave të shoqërisë civile, e cila është e rolit *watchdog*, për të mos marrë ngarkesa politike. Nëse ky vend ka vuajtur deri më sot, ka vuajtur pikërisht për shkak të ngarkesave të padrejta që i janë adresuar shoqërisë civile, në pjesën më të madhe, që gjoja i përket njërit krah politik apo një tjetri. Në mënyrë absolute nuk ishte ftesë për të mos zbatuar ligjin, po për t'i paraprirë me sa të jetë e mundur. Ju si Kuvend mund të gjeni mekanizma e forma nga më të ndryshmet për të krijuar një lloj imuniteti, në mënyrë që ata të njëzet e një që keni ftuar të jenë të gjithë këtu dhe të ndjehen komodë, duke përfshirë këtu

edhe shfaqjen e parë që u bë këtu në fillim të seancës nga kolegu juaj i opozitës, gjë që s'ishte fare e pranueshme, ose pjesa tjetër e mbrojtjes që u bë nga kolegu juaj.

Kjo vazhdon të tregojë se, në njëfarë mënyre, ka konsideratë ende me rezerva lidhur me kapacitetet që ofron shoqëria civile. Mendoj se duhet të fillohet të respektohet në dimension të plotë integriteti i ekspertizës dhe i atyre që vijnë në kuadër të shoqërisë civile.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Po, zonja Ferhati!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Hysi!

Unë kisha vetëm një sqarim: pavarësisht faktit se si mund të jetë klima politike në një vend të caktuar, ashtu siç e shpjegoi edhe zonja nënkryetare, ne duhet të ndjekim procedurat ligjore institucionale.

E kuptojmë shqetësimin që ju keni, ama një gjë duhet të jetë e qartë për publikun dhe për të gjithë ju: përveç faktit që kemi detyrimin ligjor për të bërë dëgjesa publike dhe konsultime me ju, ne edhe besojmë te këto dëgjesa. Pra, nuk është çështja se kemi një detyrim dhe thjesht po zbatojmë në mënyrë të ftohtë e mekanike pjesën e konsultimit qytetar me shoqërinë civile apo me aktorë të tjerë të grupeve të interesit. Ne besojmë te gjithçka që ju paraqitni këtu. Pastaj, se si janë perceptimet, si krijohen, si mund të përdoren nga aktorë dhe faktorë të ndryshëm, kjo është një çështje që mund të përfshihet në një debat tjetër, por jo diçka që i përket ditës së sotme. Sot ne kemi një çështje, për të cilën, përveçse po zbatojmë ligjin, për të dëgjuar shoqërinë civile, ne edhe besojmë te gjykimet tuaja. Prandaj, duam të dëgjojmë mendimet tuaja në lidhje me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Ferhati! Faleminderit, zoti Premto!

Po, zoti Krasniqi.

Zoti Krasniqi përfaqëson Institutin e Studimeve Politike. Së pari, do të doja t'ju falënderoja për monitorimin që i bëni Kuvendit, si dhe për gjithë angazhimin tuaj për rritjen e kapaciteteve të Kuvendit të Shqipërisë.

Fjala është për ju!

Afrim Krasniqi – Faleminderit!

E vlerësoj ftesën, sepse duke bërë monitorimin e parlamentit, deri diku kam edhe një lloj detyrimi institucional për ta ndjekur aktivitetin, sidomos kur ftohemi për të dhënë opinione.

Kalojmë direkt te tematika e ditës. Praktikisht, edhe unë ndaj të njëjtin shqetësim. Unë e di se ka deputetë që kaun vullnet për t'i bërë gjërat sipas Rregullores, por ky parlament

e ka ndryshuar Kushtetutën për një natë, në prill të 2008-ës. Të gjithë kemi vuajtur për të gjetur draftin e ndryshimit dhe imagjino pastaj të kishte konsultim. Sot kemi pasojat e atij ndryshimi dhe janë po të njëjtët aktorë politikë në lojë, siç ka praktika, qoftë edhe vitin e kaluar, ku kanë marrë vendime pa konsultë minimale, as formale, me strukturat e shoqërisë civile apo grupe të ndryshme interesi. Uroj që ky të mos jetë rasti dhe të jetë një ndryshim në sjelljen e parlamentit. Duhet ta shohim në të ardhmen nëse funksionon në këtë mënyrë, por personalisht, e shoh si një lloj...

Nuk mërzitem nëse partitë na kritikojnë. Partitë këtë punë dhe këto interesa kanë dhe në Shqipëri bëjnë partitë teatër, nuk bëjmë ne. Kështu që nuk ndikohem nga fjalët që u thanë sot në sallë, por ndikohem nga fakti që, kur diskutohet për ndryshimin e Kushtetutës, është një gjë kaq e madhe, sa do të duhet të kishte seriozitet maksimal. Është e habitshme që Shqipëria po shkon në 20-vjetorin e Kushtetutës së re dhe sa herë që ne zihemi fusim duart në Kushtetutë.

Unë jam nga ata qytetarë që nuk do që fëmijët e tij të kenë në Kushtetutën e tyre termin “politikan i lidhur me krimin e organizuar”. Nuk kemi pse të bëhemi vendi unik në botë, për shkak se 2-3 kryetarë partish, për interesa personale dhe politike, morën disa kriminelë dhe i futën në politikë.

Hajde të shkojmë te burimi dhe të gjejmë nëse ky ka qenë problem i 3,4,5,6 vjetëve të fundit. Mund të jetë problem edhe i 5 vjetëve të ardhshëm. Nuk mund të bëhet Kushtetuta për 10 vjet.

Kështu që nëse ndaj opinion të njëjtë, si çdo qytetar i këtij vendi, që situata nuk është normale në përfaqësimin politik, që kriteret dhe karriera në Shqipëri nuk është funksionale, që sistemi i meritës nuk funksionon dhe që për herë të parë politika lart është bërë problem (dikur ka qenë problemet poshtë, por sot kemi probleme në nivele të larta politike), hajde të shkojmë dhe t'i gjemë ato probleme, duke bërë ndryshimet e mundshme aty ku është burimi dhe zgjidhja, që është sistemi zgjedhor dhe përfaqësimi i qytetarëve, mekanizmat, por nuk jam që kjo të fillojë me skena të tilla dhe kushdo që ka një ide, ta shprehë në mënyrë automatike. Madje, nëse kjo mënyrë do të miratohet, nuk zgjidh asgjë.

Ne kemi pasur ligjin për dekriminalizimin, i cili në fund fare nuk është moment krenarie, por është një moment turpi për vendin tonë. Deri sot, me përjashtim të ndonjë institucioni ndërkombëtar, që ka treguar interes, nuk kemi një analizë nga parlamenti se sa ka funksionuar ky ligj, sa impakt ka pasur në administratë, në vendimmarrje, te partitë politike... A duhet të ndryshojmë ligjin e partive politike? A duhet të shtrëngojmë nenet përkatëse,

meqenëse po bëhet reforma zgjedhore, në Kodin Zgjedhor? A duhet që vetë partitë të kenë sanksione më të mëdha në raport me këtë gjë?

Fakti që para 4 ditësh na u dha një draft ku thuhej se kryetarët e partive duhet të deklaronin me shkrim që nuk do të blejnë vota, nuk do të shesin vota dhe nuk do të ndihmojnë më individë të kriminalizuar, është të tallesh me politikën, me Kushtetutën, me qytetarët dhe të thotë: “Na jepni sinjalin që këtu nuk do të ndryshojë asgjë.” Ky është mesazhi që nuk meritojnë shqiptarët në këtë lloj faze. Është mesazhi më i keq që mund të jepet nga politika.

Shpresoj që problematika që është ngritur, të largohet nga personazhet e ditës, që në tërë botën e civilizuar nuk përbëjnë kurrë *headline* në medie, por në Shqipëri, çuditërisht, janë *headline*.

Duhet të kishim një trajtim më serioz. Do ta mirëprisja që komisioni juaj, siç ka bërë tryeza, siç ka ndër mend t’i bëjë edhe me pedagogët dhe me të tjerët, e para, të përmbushë detyrimin ligjor që ka nga Rregullorja e Kuvendit për të bërë studime për zbatimin e ligjit në Shqipëri. E ka detyrim ligjor dhe nuk e ka bërë asnjëherë dhe, e dyta, të arrijë përmes instrumenteve të veta parlamentare të analizojë se cilat janë problematikat që kërkojnë ndërhyrje, jo në Kushtetutë, por në bazë ligjore, në mënyrë që të mos mblidhemi të hënën për reformën zgjedhore, të enjten për të shtruar një nen, që lidhet prapë me zgjedhjet dhe në fund të javës të mblidhemi prapë për një nen tjetër, ku mund të vijë një propozim për votimin elektronik apo votimin e emigrantëve, domethënë, të mos ketë një mbivendosje agjendash, por të ketë një agjendë dhe palët të bien dakord. Siç kanë rënë dakord për gjërat e tjera, të bien dakord edhe për këtë dhe të arrijnë të ofrojnë një zgjidhje të qëndrueshme, që askënd të mos e vendosë në pozitë të vështirë. Retorika nuk ofron zgjidhje, as mekanizmi formal nuk ofron zgjidhje.

Jemi të respektuar që ftohemi në komision, por, të them të drejtën, do të dëshiroja që, siç ishim ne më shumë (pavarësisht se shoqëri civile është dhe nuk ka adresë), edhe kolegët deputetë të gjenin 5 minuta kohë për të ardhur sot dhe për të na dëgjuar, përderisa na kanë ftuar, sepse ne kemi lënë angazhime të tjera për të ardhur këtu dhe normalisht kemi bërë studime për të ardhur këtu. Kështu që kjo është reciproke. Ju faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Krasniqi! Faleminderit edhe për sugjerimet!

Keni të drejtë, do të përpiqemi, të paktën ne që jemi në strukturat drejtuese të vendit, por edhe si maxhorancë, të marrim një për një edhe ato çfarë ju thatë dhe që i konsideroj të drejta.

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Krasniqi.

Kush e dëshiron fjalën?

Po, zoti Hazizaj.

Altin Hazizaj – Faleminderit, e nderuar kryetare!

Në fakt, ndonjëherë ne vendosemi në disa situata absurde. Mua më ka qëlluar të thërras me emër njëherë në kohën e komunizmit, por më ndodhi edhe sot. Janë dy sisteme të kundërta, por metodologjia është e njëjtë. Ideja është presion i hapur ndaj qytetarëve të thjeshtë, sepse të gjithë ne, pavarësisht pozicioneve që mund të kemi në organizata të ndryshme, jemi qytetarë të thjeshtë. Vendosja e qytetarit të thjeshtë para një momenti presioni, bulizmi, dhune, terrori, të them të drejtën unë e mora si terror, sepse nuk më ka qëlluar asnjëherë tjetër kjo situatë, siç e thashë më ka qëlluar njëherë në komunizëm dhe një herë sot.

Së pari, për mua e para është e patolerueshme nga ana e Kuvendit, sepse kjo nuk duhet të kishte ndodhur. Unë e kuptoj se ju nuk keni kontroll, sepse secili ka kontroll vetëm mbi veten e tij, por problemi që ngrihet është: sa të sigurt janë përfaqësuesit e shoqërisë civile kur vijnë në kontakt me partitë politike? Unë sot jam ndierë i pasigurt. Unë mendoj për sigurinë personale, për sigurinë e organizatës dhe punën që unë bëj, por mendoj edhe për sigurinë e qytetarëve të thjeshtë, sepse, siç e thashë, unë këtu vij si qytetar i thjeshtë, pavarësisht opozicionit, ekspertizës e të tjerë.

Në këtë kuadër, pa diskutim bashkohem edhe me zotin Premto, por edhe me kolegët e tjerë, për faktin se klima politike nuk duhet ta bëjë qytetarin të ndihet i rrezikuar dhe kjo gjë po ndodh. Pra, po ndodh rrezikimi i qytetarit dhe vendosja e tij në një pozicion, që është jo në qendër të vëmendjes, por në qendër të rrezikut. Se si mund të zgjidhet kjo gjë, të them të drejtën, nuk është se kam ndonjë ide në këto momente, pasi nuk e prisja këtë lloj teatri politik sot, i cili ishte shumë i shëmtuar, por mbase ne duhet të mësohemi edhe me këto ngjarje.

Meqenëse unë u lakova me emër, por edhe zonja këtu, edhe zoti Premto, mund t'ju them se kam qenë kandidat për KLGJ dhe partia X më ka atakuar me emër, kurse partia Y më ka hequr nga lista për shkak të atakimit nga partia. Kështu që po t'i marr në sensin e politikës, të dyja partitë politike kryesore i gjej pak në faj, sepse qytetarët e thjeshtë duan të kontribuojnë në ndryshimin e këtij vendi, duan të ndihmojnë në krijimin e një klime politike, e cila e çon vendin para. Në momentin që nuk ka një konsensus politik, automatikisht të humbur nuk janë politikanët dhe kjo është e sigurt. Unë jam i sigurt se zotëria do të vazhdojë të bëjë milionat e radhës, siç do të vazhdojnë mbase t'i bëjnë edhe të tjerët që janë në politikë. Ky është perceptimi im për një pjesë të deputetëve dhe kjo është e vërteta.

Në fakt, ajo që mua më prek është modeli që u japim qytetarëve. Domethënë, unë punoj për fëmijët dhe për të rinjtë dhe dje në një sallë tjetër ne organizuam një samit të vajzave, e cila kaloi në mënyrë perfekte. Ideja ishte se çfarë modeli duhet t'u jepnim vajzave që t'i ftojme në udhëheqje. Unë mendoj se këto modele, si ky i sotmi, jo vetëm për vajzat, por për këdo, janë modele të gabuara të të bërit politikë. Kështu që kam një thirrje për të gjithë, jo vetëm për zotërinë që u largua, pasi më lakoi emrin, hajdeni të mendojmë se çfarë modeli do të japim! Një model i gabuar do të thotë se politika në Shqipëri jo vetëm sot, sepse sot e dimë se sa konfliktuale është, por edhe në vitet e ardhshme do të vazhdojë të jetë po kaq konfliktuale, sepse ky është modeli që ne po u mësojmë nxënësve.

Për sa u përket ndryshimeve të propozuara në Kushtetutë, unë jam i detyruar të flas si ekspert dhe nuk do të futem në detaje të ndryshimeve kushtetuese, pavarësisht se ne i kemi përgatitur dhe i kemi rishikuar. Ajo që unë dua të vlerësoj është fakti se çdo përpjekje e partive politike për të rregulluar ose për të pastruar dhe për të ndarë përfundimisht politikën nga krimi i organizuar patjetër që është përpjekje që duhet vlerësuar. Kështu që në këtë kuadër ne kemi një vlerësim pozitiv për sa i përket nismës së Partisë Demokratike dhe të mbështetur të paktën me ç' duket nga firmat dhe nga LSI-ja. Nga ana tjetër, siç u shpreh shqetësimi nga kolegët e tjerë ndryshimet e pamenduara në Kushtetutë dhe të pakonsultuara gjerësisht, jo thjesht me shoqërinë civile, por me grupime të qytetarëve, kanë tendencën që të krijojnë një bumerang në jetën politike dhe njëkohësisht në zbatimin e ligjeve.

Në këtë kuadër, do të nxisim dy momente kryesore: e para, një diskutim sa më të gjerë të ndryshimeve të propozuara, pavarësisht se teksti lë shumë për të dëshiruar, por ky është diskutimi teknik i ekspertëve dhe, e dyta, vlerësimi i nismës që ka ardhur me seriozitetin më të madh të mundshëm nga ana e Partisë Socialiste, mund të jetë edhe një moment i mirë konsensusi.

Në aspektin e përmbajtjes ka shumë probleme, por në aspektin e nismës të mundohemi të gjejmë zgjidhjet më të mira për ndarjen e politikës nga krimi i organizuar. Ka dyshime, ka raste që kanë ndodhur, por edhe PD-ja ka përgatitur një mini relacion për sa u përket rasteve të deputetëve të akuzuar dhe jemi në dijeni për këtë gjë, por edhe ju vetë duhet të bëni përpjekje për të arritur këtë konsensus, ia vlen, sepse në fund ata që përfitojnë janë qytetarët.

Është shumë komod kur je si në pozitë, por edhe në opozitë. Pozita edhe mund të mos i pëlqejë ndryshimet dhe e ka më të lehtë të thotë bëra këto dhe këto procedura dhe në fund fare të thotë jo, sepse ka të bëjë me votën dhe me kartonin, por nga ana tjetër mosarritja

e këtij konsensusi, zhgënjën pritshmëritë se si duam ne të jenë politikanët tanë. Kjo mund të jetë edhe humbja më e madhe dhe jo ana procedurale.

E fundit, mbas një konsultimi shumë të gjerë me shoqërinë civile do të kërkonim që të bëni një përpjekje për të ftuar edhe kolegët e PD-së. Edhe sikur të na vendosin emër ose për momentin të na tregojnë me gisht, që ti je ai Altini, nuk na gjen gjë, sepse në fund të ditës çdo njeri ka dinjitetin dhe karakterin e tij, por përtej kësaj ejani të bëjmë një përpjekje serioze të gjithë së bashku dhe mbase gjejmë një zgjidhje, ku i dihet. Është kushtetuese apo ligjore, këtë e bëjmë me anë të ligjit dhe ky është diskutim teknik, por sot humbi sensi i diskutimit teknik. Më mirë të mos flas si teknik. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Hazizaj!

Edhe unë dua të të falënderoj për të gjithë kontributin dhe për aktivitetin e djeshëm!

E kuptoj shumë mirë shqetësimin tuaj, meqenëse edhe zoti Premto e përmendi reagimin tonë, unë doja të merrja fjalën për procedurë, sepse është cenuar neni 6 i Kodit të Sjelljes, “Gjuha joparlamentare ndaj të ftuarve” dhe do të kërkoj mbledhjen e Byrosë. Ngrita dorën të protestoja, nuk e bëra për të parë nëse jeni në anën tonë apo jo, por doja të zbatoja Kodin e Sjelljes dhe, sipas Rregullores, fjala jepet menjëherë kur kërkohet për procedurë. Kemi miratuar një Kod Sjellje, që sot është shkelur në formën më flagrante, të paktën në 10 vjet që unë jam deputete e Kuvendit të Shqipërisë. Mes nesh dhe shoqërisë civile është shkelur shumë shpesh Kodi i Sjelljes.

Unë do të vlerësoja shumë nëse mendimet do t’i sillni me shkrim. Një pjesë e organizatave i kanë sjellë edhe me shkrim. Në këtë nismë ka racionalitet dhe, nëse bëhet i gjithë ky proces, ashtu sikurse tha edhe Kryetari i Kuvendit, do të bëhet për të shkuar drejt kompromisit.

Kurrsesi nuk mund të pranojmë atë që thonë kolegë: “O merreni nismën siç është dhe kalojeni brenda një jave pa konsultim, ose nuk ka,” se jemi në kushtet e situatës së jashtëzakonshme. Kjo nuk mund të pranohet. Po të mos ju ftonim sot, patjetër do të ishim në rrjetet sociale që Kuvendi nuk e konsulton nismën. Kjo është ajo çfarë ndodh. Faleminderit!

Kush e do fjalën, meqenëse nuk zbatuam radhën e sjellë nga administrata e Kuvendit, të regjistrimit të organizatave?

Fjalën e ka zoti Bari.

Alfred Bari – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë jam Alfred Bari, përfaqësues i Shoqatës së Avokatëve Penalistë të Shqipërisë.

Në radhë të parë, ju falënderoj për ftesën, për të dhënë sadopak kontributin tonë në këtë nismë që ka bërë opozita për ndryshimet kushtetuese.

Atë që ne duam të shprehim, zonja kryetare, do ta paraqesim me shkrim, në një analizë të shkurtër për ndryshimet që propozon opozita. Shqetësimi ynë, të cilin e trajtoi edhe zoti Krasniqi, ka të bëjë me ndryshimet e shpeshta që i janë bërë Kushtetutës gjatë këtyre viteve, sepse ne mendojmë se ndryshimet kushtetuese duhet të vijnë për shkaqe dhe arsye madhore.

Në lidhje me këtë çështje kishim përgatitur një pyetje për të cilën donim të dinim mendimin e opozitës. Duke pasur parasysh faktin që nenet e propozuara nga opozita kanë një ngjashmëri ose paralelizëm me ligjin nr. 135, i vitit 2015 të dekriminalizimit çfarë ka ligji i ndryshimeve kushtetuese i vetëgjatë që nuk e ka ligji i dekriminalizimit?

Në këto kushte kur opozita nuk është e pranishme, kjo pyetje ngelet për t'u diskutuar në seancat e mëvonshme, që do të organizojë ky komision.

Gjithashtu, duke u nisur nga faktet e cituara, mendojmë se projektligji i paraqitur nga opozita nuk i plotëson kriteret dhe nuk është i rëndësishëm për marrjen e një nisme për ndryshimet kushtetuese.

Kaq janë pak a shumë ato që unë kisha. Të gjitha çështjet që kemi do t'jua paraqesim edhe me shkrim. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti Bari!

Do ta vlerësonim shumë mendimin me shkrim edhe për pyetjen që ju keni për kolegët. Është kjo arsyeja që Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit parashikojnë dy relatorë kur ka ndryshime kushtetuese, njëri duhet të jetë nga grupi nismëtar dhe tjetri duhet të jetë nga grupimi tjetër. Pyetjen që keni ju edhe ne si deputetë, ua kemi parashtruar konstitucionalistëve, dhe Komisionit të Venecies. Faleminderit!

A keni pyetje kolegjë, apo do të vazhdojmë?

Fjala është për ju, zonja Brari, në emër të Shërbimit Ligjor Falas.

Ju falënderoj ju dhe ekspertët për amendamentet që na sollët për ligjin e gjendjes civile, si dhe për zgjidhjen e problemit të më shumë se 10 mijë fëmijëve në Shqipëri!

Rudina Brari – Ju falënderoj për ftesën! Në fakt, nuk do ta zgjas shumë fjalën time, pasi folën kolegët. Çdo gjë që ne kemi do t'jua paraqesim me shkrim si grup ekspertësh.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Nuk e di nëse ka përfaqësues të tjerë, por do ta vlerësoj shumë edhe në emër të Kuvendit të Shqipërisë të kishim mendimin me shkrim, por edhe nëse do të kishte pyetje, sepse ato do të na orientonin kur deputetët të fillojnë diskutimin me grupin e konstitucionalistëve. Ndërkohë, projektligji ka shkuar në Komisionin e Venecies, së bashku

me pyetjet, qëndrimet e grupeve parlamentare, ne jemi në pritje dhe besoj se shumë shpejt do të kemi një vlerësim nga Komisioni i Venecies.

Të nderuar kolegë, a keni pyetje? Jo.

Para se t'ju falënderoja, do të doja t'ju kërkoja ndjesë në emër të Kuvendit të Shqipërisë, pasi sot jeni vënë në një pozitë shumë të vështirë! Personalisht ndihem keq, sepse së bashku me kolegët e mi jam propozuese e një projektrezolute për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilën do ta kalojmë shumë shpejt në seancë plenare dhe nuk do të më vinte mirë që ne të jemi shkelësit e kësaj rezolute. Sinqerisht, ndihemi keq, megjithatë besoj se do të ketë një reflektim nga ana jonë dhe do të bëjmë të gjitha përpjekjet për të bërë më të mirën, por do ta vlerësoja shumë angazhimin tuaj në Kuvend, si dhe të gjitha përpjekjet që ju keni bërë për demokratizimin e jetës parlamentare, për shtetin e së drejtës dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ne jemi borxhli ndaj jush, ndaj statusit të organizatave të shoqërisë civile dhe sot, të them të drejtën, jo vetëm unë, por edhe kolegët e mi jemi ndjerë shumë keq. Fjalën e kërkoj kryetari i Komisionit të Ligjeve, zoti Manja.

Ulsi Manja - Në fakt, unë e kërkoja fjalën në mbështetje të kësaj që ju sapo thatë. Politika nuk e ka luksin t'i japë leksione shoqërisë civile. E kundërta është e vërtetë.

Unë, zonja drejtuese, do të kërkoja që, pavarësisht se mediet ishin prezent dhe jam i bindur që e kanë pasqyruar *live* këtë sjellje të kolegut të opozitës, zotit Alibeaj, ky problem të shtrohet në Konferencën e Kryetarëve, që të ketë një qëndrim për shkeljen e Kodit të Etikës nga ana e kolegut, por edhe shkeljen e Rregullores së Kuvendit.

Sinqerisht, ajo sjellje është përtej çdo lloj limiti ose etike politike dhe nuk i ka hije një juristi. Ka çfarë ka politika brenda për brenda, ne i kemi tribunat politike ku mund ta sulmojmë njeri-tjetrin dhe nuk besoj se ishte ky momenti dhe kjo tryezë momenti për të sulmuar përfaqësuesit e shoqërisë civile, por edhe për transparencë të opinionit publik, fakti që kolegët e opozitës kanë kohë që e kanë bojkotuar Kuvendin dhe të gjitha komisionet parlamentare, nuk do të thotë që Komisioni i Ligjeve, komisionet e tjera, por edhe Kuvendi nuk ka komunikim me aktorët e shoqërisë civile, përkundrazi, ne kemi një listë si komision që komunikojmë me organizatat e shoqërisë civile. Ajo nuk është shteruese, sepse organizatat e shoqërisë civile janë shumë më tepër se kaq, por kjo nuk do të thotë se konsultimi i vazhdueshëm me shoqërinë civile ka munguar. Ka problemet e veta, ka defektet e veta, çdo gjë do të vijë drejt përmirësimit, por rasti i sotëm është rast i paprecedent.

Qytetarë të përgjegjshëm që vijnë të japin kontribut për vendin sulmohen në mënyrë të paturpshme nga një parti politike, nga një përfaqësues i një partie politike që pretendon të

vijë në pushtet. Ky është mesazhi më i gabuar që u japim qytetarëve shqiptarë, aq më tepër në një takim me përfaqësues të shoqërisë civile.

Ndaj unë do të kërkoj edhe në Konferencën e Kryetarëve për të mbajtur një qëndrim. Kjo nuk mund të vazhdojë më kështu. Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Zoti Braho.

Spartak Braho – Edhe unë dua të falënderoj praninë e përfaqësuesve të shoqërisë civile, por dua të theksoj që unë hyj tek ata që nuk kam ndonjë iluzion për opozitën. Edhe ju kot bëni sikur ju vjen keq, sepse ata këtë rrugë kanë nisur dhe do ta çojnë deri në fund. Nuk më vjen keq fare, madje më vjen mirë që shoqëria civile është prezent këtu, le t'i shohin se çfarë bëjnë! Ata duan t'i vënë zjarrin tërë reformës dhe vendit. Nuk kemi se çfarë të bëjmë më ta, na ka rënë të merremi. Ne do të vazhdojmë punën, zonja drejtuese!

Edhe një herë i falënderoj zotërinjtë!

Nuk ka rëndësi se sa kanë ardhur. Sot kanë ardhur 5, por nuk përcakton numri, përcakton cilësia. Nuk duam numra, duam cilësi. Ne do t'i shohim ashtu siç e kemi përcaktuar qëndrimin tonë. Faleminderit!

Vasilika Hysi-Faleminderit!

Faleminderit, të nderuar kolegë të shoqërisë civile, për të gjithë kontributin! Ne mirëpresim sugjerimet dhe sapo të vijë opinionin nga Komisioni i Venecies, ne do ta ndajmë me ju edhe për të ditur pozicionin e Komisionit të Venecies, por edhe për të filluar më pas debatin për aspektet e karakterit teknik dhe legjislativ.

Faleminderit, përfaqësuesve të medias!

Faleminderit punonjësve të stafit të Kuvendit!

Ju uroj ditë të mbarë!